

VENDIM
Nr.869, datë 22.12.2004

PËR SHPËRBLIMIN E PERSONAVE, QË PËRFITOJNË PENSION

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 66, shkronja “ç”, e 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004” dhe të nenit 29/1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, që përfitojnë pension sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë një shpërblim të menjëhershëm, në shumën 3500 (tre mijë e pesëqind) lekë.

Këtë shpërblim e përfitojnë edhe veteranët e luftës, që nuk marrin pension, por përfitojnë vetëm nga statusi i veteranit të luftës, si dhe personat që përfitojnë pension për merita të veçanta.

2. Personat, që përfitojnë pension sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, si dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë një shpërblim të menjëhershëm, në masën 1500 (një mijë e pesëqind) lekë.

3. Përfitojnë nga ky vendim të gjithë personat, që përfshihen në pikat 1 e 2 të këtij vendimi dhe që vazhdojnë të marrin pension deri më datë 31.12.2004, përfshirë edhe këtë datë.

4. Shpërndarja e këtij shpërblimi të bëhet nëpërmjet Postës Shqiptare, sh.a.

5. Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2004, t’i shtohet fondi prej 1 597 000 000 (një miliardë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë) lekësh, për mbulimin e shpërblimit të personave, që përfitojnë pension.

6. Ky fond të përballohet nga kursimet në fondin e personelit, të planifikuar në buxhetin e vitit 2004, miratuar për ministrinë dhe institucionet qendrore, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**KURSIMET NGA FONDI I PAGAVE+SIG.SHOQERORE TE INSTITUCIONEVE BUXHETORE
PER VITIN 2004**

ne 000/leke

Gr	Institucionet Buxhetore	Totali
3	Keshilli Ministrave	13,000
4	Ministria Industrise dhe Energjitikes	32,000
5	Ministria Bujqesise dhe ushqimit	8,000
6	Ministria e Rregullimit Territorit dhe Turizmit	40,000
7	Ministria e Ekonomise	27,000
8	Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	14,000
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	2,000
10	Ministria e Financave	23,000
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences*	396,000
12	Ministria e Kultures, Rinise dhe Sporteve	3,500
13	Ministria e Shendetesise*	587,000
14	Ministria e Drejtesise	36,500
15	Ministria e Puneve te Jashtme	18,000
16	Ministria e Rendit Publik	0
17	Ministria e Mbrojtjes	120,000
18	Sherbimi Informativ Shtetror	21,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	3,500
21	Drejtoria e Rezervve se Shtetit	2,000
22	Akademia e Shkences	6,500
24	Kontrolli Larte i Shtetit	2,500
25	Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale	20,000
26	Ministria e Mjedisit	4,000
27	Agjensia Kombetare e Privatizimit	5,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	40,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjygsor	30,000
30	Gjykata Kushtetuese	5,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	3,300
32	Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit	25,000
35	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	5,000
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	2,500
39	Drejtoria e Pergjith. e Pyjeve dhe Kullotave	28,000
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	33,000
50	Instituti Statistikes	13,000
54	Enti Kombetar i Zonave te Lira	200
55	Shkolla e Magjistratures	1,000
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	1,200
59	Instituti i Integritetit te Permdjekurve Politik	4,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	1,500
64	Keshilli Kombetar i RTV	0
66	Avokati i Popullit	2,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	0
75	Avokati i Shtetit	2,000
76	Inspektoriati i Larte Kontr. Deklarim Pasurise	12,000
77	Autoriteti i Konkurences	3,800
	TOTALI	1,597,000